VENDIM
Nr.135, datë 18.12.2008

PËR NJË DEVIJIM NGA RREGULLAT E PRAKTIKËS DHE PROCEDURAVE TË ERE-S NË LIDHJE ME SHQYRTIMIN E APLIKIMIT PËR LICENCIM TË SHOQËRISË "TERMOCENTRALI VLORË" SHA

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nenit 38 të rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.44, datë 24.7.2007, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 18.12.2008, pasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë "Termocentrali Vlorë" sh.a.,

dhe konstatoi:

- Nevojën për të filluar procedurat e shqyrtimit të aplikimit për licencim të shoqërisë "Termocentrali Vlorë" sh.a., pavarësisht mosparaqitjes së aplikimit sipas formatit të përcaktuar nga ERE në rregulloren për procedurat e licencimit, duke vlerësuar se:
- Shoqëria "Termocentrali Vlorë" sh.a., është duke kryer një investim publik përmes ngritjes së një termocentrali në zonën e Vlorës.
- Ky investim shënon një nga investimet më të mëdha për sektorin elektroenergjetik i kryer me kontributin e përbashkët të Bankës Botërore, BERZH, BEI, marrëveshje këto të ratifikuara nga Kuvendi i Shqipërisë.
- Duke filluar nga muaji shkurt 2009 do të kryhet testimi dhe komisionimi i termocentralit.
- Investimi pritet të përfundojë në maj të vitit 2009, kohë kjo që lidhet me fillimin e vënies në punë të termocentralit.
- Vënia në punë e termocentralit do të thotë që shoqëria "Termocentrali Vlorë" sh.a., të fillojë të ushtrojë aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike.
- Ligji nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike" përcakton se ky aktivitet ushtrohet kundrejt licencimit nga ERE.
- Procedurat e licencimit nga ERE kërkojnë paraqitjen e tij sipas formatit të përcaktuar nga ERE para se Bordi i Komisionerëve të marrë vendim për fillimin e procedurave.
- Mosfillimi i procedurave të vononte procesin e licencimit duke konsideruar se kërkohet një afat prej 90 ditësh nga marrja e vendimit për fillim procedure deri në marrjen e vendimit për licencimin e një shoqërie,

për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

VENDOSI:

1. Të kryejë një devijim nga neni 18 i rregullave të praktikës së procedurave të ERE-s, në lidhje me fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit të shoqërisë "Termocentrali Vlorë" sh.a., pavarësisht mosplotësimit tërësisht të aplikimit sipas formatit të kërkuar nga ERE.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, si dhe Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, për vënien në dijeni të aplikuesit për këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta